

VENDIM
Nr. 542, datë 15.8.2014

PËR KONTRIBUTIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË IRAKUT, NË KUADËR TË PËRPJEKJEVE TË KOALICIONIT NDËRKOMBËTAR NË LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 987, DATË 1.12.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KONTRIBUTIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR QEVERINË AFGANE, NË KUADËR TË PËRPJEKJEVE TË KOALICIONIT NDËRKOMBËTAR KUNDËR TERRORIZMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 14, të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000, “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien, pa shpërblim, qeverisë së Republikës së Irakut, të armëve dhe municioneve sipas tipave dhe llojeve të përcaktuara në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, në kuadër të përpjekjeve të koalicionit ndërkombëtar në luftën kundër terrorizmit.

2. Pika 1 e vendimit nr. 987, datë 1.12.2010, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Dhënien, pa shpërblim, të 10 000 (dhjetë mijë) automatikëve 7.62 mm, model 56, qeverisë afgane, për Policinë Kombëtare Afgane, si kontribut i Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të përpjekjeve të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit.”.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TABELA NR. 1

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Fishekë 7.62 mm, model 56	copë	22.000.000
2	Granata dore mbrojtëse	copë	15.000
3	Predha mortaje 60 mm	copë	15.000
4	Predha mortaje 82 mm	copë	12.000
5	Predha mortaje 120 mm	copë	5.000
6	Shtimje 40 mm GHLKT, model 1969	copë	20.000

Tabela mbaron me numrin rendor 6 (gjashtë).